

## **Eksperti i Kombeve të Bashkuara për të drejtën e zhvillimit viziton Shqipërinë**

GJENEVË (10 nëntor 2022) – Raportuesi i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për të drejtën e zhvillimit, Saad Alfarargi do të zhvillojë një vizitë zyrtare në Shqipëri nga data 15 deri më 24 nëntor 2022 për të vlerësuar përpjekjet në vend për integrimin e të drejtës së njeriut për zhvillim në politikat vendase.

“Pres me kënaqësi të takohem me përfaqësues të qeverisë dhe me aktorë të tjerë që punojnë për zbatimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe për nxitjen e realizimit të së drejtës për zhvillim,” tha Alfarargi.

Gjatë vizitës së tij në Shqipëri, Alfarargi do të shohë se si e nxit dhe si e garanton qeveria pjesëmarrjen efikase të qytetaravë dhe llogaridhënien në procesin e zhvillimit. Eksperti i Kombeve të Bashkuara do të vlerësojë edhe shkallën e zbatimit të së drejtës për zhvillim në reagimin dhe në masat rikuperuese që qeveria shqiptare ka ndër marrë në lidhje me pandeminë e shkaktuar nga COVID-19.

“E drejta për zhvillim fokusohet te gjithëpërfshirja, nxitja e barazisë dhe shpërndarjes së barabartë të përfitimeve të rritjes ekonomike dhe zhvillimit,” tha Alfarargi. “E drejta e zhvillimit kërkon gjithashtu që nismat për zhvillim të jenë të qëndrueshme dhe të kenë të integruara në to shqetësimet në lidhje me mjedisin dhe klimën.”

Eksperti u shpreh se qëllimi i përgjithshëm i kësaj vizite është që të ndihmojë qeverinë për ta përforcuar legjislacionin, politikat dhe praktikën në përputhje me [Deklaratën e vitit 1986 për të Drejtën për Zhvillim](#).

Gjatë vizitës së tij, Alfarargi do të takohet me zyrtarë publikë, aktorë ndërkombëtarë për zhvillimin dhe me përfaqësues të shoqërisë civile në Tiranë dhe në Elbasan.

Raportuesi i Posaçëm do t'i prezantojë vëzhgimet e tij paraprake gjatë një konference për shtyp më 24 nëntor 2022, në orën 14:00, me orën lokale, në Hotel Rogner në Tiranë. Në këtë konferencë do të mund të marrin pjesë vetëm gazetarët.

Raporti mbi vizitën do t'i paraqitet Këshillit të të Drejtave të Njeriut në shtator të vitit 2023.

### **FUND**

*Z. Saad Alfarargi (Egjipt) është emëruar i pari [Raportues i Posaçëm për të drejtën për zhvillim](#) nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut në vitin 2017. Z. Alfarargi ka shërbyer si*

Ambasador dhe Ligës së Shteteve Arabe në Kombet e Bashkuara dhe në Organizatat Ndërkombëtare në Gjenevë (1998-2012); Drejtor Rajonal për Shtetet Arabe, Asistent Administrator, UNDP, Nju Jork (1995-1997); Ndihmës i Ministrit të Punëve të Jashtme të Egjiptit; Shef i Zyrës së Presidentit për Çështjet Ekonomike, Kajro (1992-1995); dhe si Ambasador dhe Përfaqësues i Përhershëm i Egjiptit në Kombet e Bashkuara dhe në Organizatat Ndërkombëtare në Gjenevë. Ai është diplomuar dhe ka bërë Master Shkencor në Universitetin e Kajros, si dhe një diplomë për Marrëdhëniet Ndërkombëtare nga London School of Economics.

Raportuesit e Posaçëm janë pjesë e të ashtuquajturave [Procedura të Posaçme](#) të Këshillit të të Drejtave të Njeriut. Procedurat e Posaçme, organi më i madh i ekspertëve të pavarur në sistemin e të Drejtave të Njeriut të OKB-së, është emri i përgjithshëm për mekanizmat monitoruese dhe faktmbledhëse që adresojnë situatat specifike në vende të ndryshme në të gjitha pjesët e botës. Ekspertët e Procedurave të Posaçme punojnë në mënyrë vullnetare; ata nuk janë staf i OKB-së dhe nuk marrin pagesë për punën që bëjnë. Ata janë të pavarur nga çdo qeveri apo organizatë dhe shërbejnë në cilësinë e tyre individuale.

Të Drejtat e Njeriut të OKB-së, Faqja zyrtare — [Shqipëri](#)

Për më shumë informacione apo pyetje, ju lutemi kontaktoni: në Shqipëri, znj. Nora Kushti +355 [692090253](tel:692090253)/[nora.kushti@undp.org](mailto:nora.kushti@undp.org), në Gjenevë: znj. Antoanela Pavlova ([antoanela.pavlova@un.org](mailto:antoanela.pavlova@un.org)) ose shkruani në [hrc-sr-development@un.org](mailto:hrc-sr-development@un.org).

Për pyetje nga media në lidhje me ekspertët e tjerë të pavarur të OKB-së, ju lutemi kontaktoni Renato de Souza ([renato.rosariodesouza@un.org](mailto:renato.rosariodesouza@un.org)) ose Dharisha Indraguptha ([dharisha.indraguptha@un.org](mailto:dharisha.indraguptha@un.org))

Ndiqui lajmet në lidhje me ekspertët e pavarur të të drejtave të njeriut të OKB-së në Twitter: @UN\_SPExperts.

Të shqetësuar për botën ku po jetojmë?  
Atëherë, NGRIHUNI për të drejtat e dikujt sit.  
#Standup4humanrights  
dhe vizitoni faqen zyrtare në <http://www.standup4humanrights.org>